



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 2033/1 prot.

Tiranë, më 13.12.2021

Lënda: Mendim për projektvendimin “Për mënyrën e ngritjes, administrimit, mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për rininë, si dhe mënyrën e ndërveprimit të saj me bazat e tjera të të dhënave shtetërore”

MINISTRIT TË SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

KRYEMINISTRIA

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.6165 prot., datë 10.12.2021, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin “Për mënyrën e ngritjes, administrimit, mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për rininë, si dhe mënyrën e ndërveprimit të saj me bazat e tjera të të dhënave shtetërore” dhe relacionin shpjegues, më poshtë gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

Nga shqyrtimi i projektvendimit dhe relacionit, konstatohet se krijimi i Regjistrat Elektronik për Rininë (në vijim RER) bazohet në ligjin nr. 75/2019 “Për rininë” dhe ligjin nr. 10 325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”. Gjithashtu, krijimi i kësaj baze të dhënash nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

Nga përmbajtja e pikës 3 të projektvendimit, vërejmë se të dhënat ndahen në dy kategori, në të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore. Ndërkohë në pikën 4 dhe 5 të projektvendimit parashikohen rregulla mbi mbrojtjen e të dhënave personale.

Për sa më lart, me qëllim garantimin e masave për sigurinë e të dhënave personale që do të përpunohen në RER, sugjerojmë që pas shkronjës c), të pikës 4, të projektvendimit të shtohen dhe dy pika, me këtë përmbajtje:

- *garantimin e masave teknike dhe organizative të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, humbje aksidentale, për të mbrojtur*

- aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi;*
- *kryerjen e çdo veprimi në sistem lidhur me aksesin, ndryshimin, korrigjimin, përhapjen e të dhënave, etj, duke lenë gjurmë me qëllim garantimin e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave;*

Me përfshirjen e sugjerimeve të mësipërme, projektvendimi vlerësohen në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

